



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, më ____ . ____ 2011

FTESE

Ftesë për Negociatë për prodhimin e një spoti publicitar, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare.

Në vëmendje të: _____

TIRANE

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për trasmetim nga Operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë trasmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare, Ju dërgon këtë ftesë për pjesëmarrje për realizimin dhe prodhimin e një spoti publicitar, informues, televiziv për publikun.

AKEP, pas realizimit të kontratës me objekt: “*Blerje e bazës së të dhënave reference të centralizuar për Portabilitetin e Numrit*”, ka planifikuar fillimin e procesit të portimit të numrave.

Për këtë arsye, duke marrë në konsideratë dhe eksperiencën e rregullatorëve të rajonit e më gjërë, por edhe si një detyrim që ka institucioni jonë për të informuar konsumatorin për fillimin e këtij shërbimi, kërkojmë të realizojmë këtë proces, nëpërmjet prodhimit dhe transmetimit të një spoti publicitar si më poshtë:

1. Prodhimin dhe transmetimin e spotit me objekt: “*Realizimi i spotit publicitar për portabilitetin e numrit*”, i cili duhet të përmbajë këto specifikime:

- a) **Gjatësia e Reklamës:** 15-18 sekonda;
- b) **Grafika :** Animim dhe duhet të përmbajë numra telefoni;
- c) **Audio:** Spoti duhet të shoqërohet me voice over, dhe;
- d) **Logo e AKEP:** Në spot duhet të shfaqet logo e AKEP-it.

2. Shpeshësia e transmetimit së spotit, do të jetë 1(një) herë në ditë, në mediat kombëtare në vend, përpara edicionit qëndror të lajmeve. Kohëzgjatja e transmetimit në media, do të jetë 5 (pesë) ditë rresht, duke filluar nga data 25.04.2011 deri në datën 30.04.2011. Numri i televizioneve kombëtare, ku do të transmetohet spoti publicitar është 3(tre).

3. Fondi limit për prodhimin e spotit është 300 000 (treqind mijë) lekë me TVSH dhe fondi limit për transmetimin është 700 000(shtatëqind mijë) lekë me TVSH.

4. Organi i masmedias/Agjencia e specializuara, do të përzgjidhet në përputhje me procedurat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për trasmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë trasmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore”.

Shprehjet e interesit nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura, në datën **07.04.2011, ora 12.00, në adresën:**

**Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Rruga “Reshit Çollaku”, Nr.43, Tiranë, Shqipëri.**

Për çdo sqarim të mëtejshëm mund të kontaktoni në:

Tel: 0355 4 259571

Fax: 0355 4 259106

E-mail: info@akep.al

Web site: www.akep.al

K R Y E T A R I

PIRO XHIXHO